

## Para se të filloni

- ▶ Përdoreni këtë listë kontrolli për t'i ndihmuar studentët të mbarojnë tezat dhe t'i publikojnë ato duke respektuar standardet etike dhe duke shmangur sjelljen e keqe profesionale.
- ▶ Qëllimi i kësaj liste kontrolli është të ndihmojë mentorët në mbikëqyrjen e shkrimit dhe publikimit të tezave të magistraturës dhe doktoratës në përputhje me normat dhe vlerat e integritetit akademik dhe kërkimor.
- ▶ Lista e kontrollit duhet të ndihmojë studentët të përgatisin tezën dhe publikimet e tyre shkencore në përputhje me praktikën më të mirë të kërkimit dhe të shmangin rreziqet e sjelljes së pahijshme gjatë punës kërkimore dhe praktikave të dyshimta kërkimore.
- ▶ Lista e kontrollit duhet të përdoret që nga fillimi i mbikëqyrjes dhe gjatë gjithë procesit të përgatitjes së tezës.
- ▶ Kini parasysh se lista mund të duhet të përshtatet me nevojat tuaja në varësi të fushës së kërkimit, përvojës suaj të kaluar dhe politikave dhe rregullave institucionale.
- ▶ Në varësi të ndarjes së përgjegjësisë në nivel institucional, mund të mos jeni ju që po ndërmerri disa nga pikat e renditura më poshtë, por megjithatë duhet të siguroheni që studenti juaj të udhëhiqet siç duhet.
- ▶ Mund të jetë e dobishme të trajtohen disa nga këto pika në grupe prej dy ose më shumë studentëve.

## Këshilla të përgjithshme

- ▶ Kini parasysh se ju shërbeni si një model.
- ▶ Inkurajoni studentët tuaj në disiplinën tuaj dhe ndihmohuni ata të kalojnë urën nga të qenit student në hulumtues.
- ▶ Inkurajoni studentët tuaj të ndërveprojnë me komunitetin e kërkimit shkencor dhe të marrin pjesë në ngjarje akademike.
- ▶ Inkurajoni studentët tuaj të mendojnë për veten dhe ndihmohuni ata të zhvillojnë të menduarit kritik.
- ▶ Përpiqui t'i motivoni studentët tuaj dhe pyesni ata për punën e tyre hulumtuese dhe mbarëvajtjen e saj.
- ▶ Tregojuni studentëve se jeni aktiv dhe i angazhuar me tezat dhe punimet e tyre shkencore.
- ▶ Këshillojini studentët të mbajnë një ditar kërkimor si një mënyrë e dobishme për të ruajtur të gjitha informacionet e rëndësishme në një vend.
- ▶ Nëse paraqitet ndonjë problem, përpiqui ta zgjidhni atë në dobi të studentit, pa asnjë presion.

## Emri:

.....

## Përgatitjet e përgjithshme për mua si mentor

- I lexova kërkesat institucionale në lidhje me mentorimin e tezës dhe, sipas nevojës, kam ndjekur kurset e nevojshme për mentorim
- E di se cilat janë kërkesat për cilësinë e tezës në institucionin tim.
- E di se ku mund të gjej informacion në institucionin tim për detyrat dhe proceset e mentorimit.
- Kam njohuri për integritetin akademik dhe kërkimor, duke përfshirë shkeljet e ndryshme si angazhimi i një pale të tretë për të kompletuar detyrat, mullinjte e punimeve (organizatat që shesin në mënyrë jo etike punimet të studentëve) shtimi i një autori në një punim pa kontribut, plagjiatura dhe çështjet e menaxhimit të të dhënave.

## Integriteti akademik dhe kërkimor

- Kam folur me studentin tim mbi vlerat e integritetit akademik dhe kërkimor dhe pse është e rëndësishme të nxiten praktikave të përgjegjshme akademike dhe kërkimore.
- Kam kontrolluar nëse studenti ka marrë trajnimin e duhur për integritetin akademik dhe kërkimor.
- Ne kemi rënë dakord që teza dhe publikimet e studentit të bëhen duke respektuar integritetin akademik dhe kërkimor.
- I kam shpjeguar studentit tim pasojat e pandershmerisë në punën kërkimore (p.sh., plagjiatura, fabrikimi të dhënave dhe shkelje të tjera të etikës dhe procedurave akademike).
- Nëse studentët tuaj nuk kanë ndjekur më parë kurse për integritetin akademik dhe kërkimor, ju mund t'i drejtoni në burime institucionale ose burime të besueshme si ato në <https://www.academicintegrity.eu/wp/all-materials/>.
- I kam udhëzuar studentët e mi se si të gjejnë të gjitha dokumentet e rëndësishme, siç është kodi i etikës.

## Përgatitjet për punën e studentëve

- Me studentin kemi rënë dakord për takime të rregullta individuale ose grupore dhe po ndjekim orarin.
- Studenti dhe unë kemi rënë dakord të respektojmë orarin e punës së njëri-tjetrit dhe të shmangim kontaktet me njëri-tjetrin gjatë fundjavave dhe gjatë pushimeve.
- Kam caktuar një orar të përshtatshëm pune me studentin dhe kemi rënë dakord për afatin kohor që ai/ajo do të ndjekë.
- Jam këtu për të mbështetur studentët e mi dhe ata e dinë se do të bëj çmos për t'i ndihmuar; ata gjithashtu e dinë se si dhe kur të më gjejnë.
- Përpara se të bëhet mbledhja e të dhënave, kontrollova nëse kërkimi shkencor i studentit tim ka nevojë për miratim etik dhe e ndihmova atë lidhur me këtë procedurë.

## Formulimi i pyetjeve kërkimore dhe dizajni i studimit

- Studenti dhe unë kemi diskutuar për kërkimet e literaturës dhe si të gjejmë literaturën përkatëse kërkimore.
- Studenti dhe unë kemi diskutuar se çfarë lloj kontributi do të japë teza e tyre në hulumtimet ekzistuese në fushën tonë.
- Studenti dhe unë kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord për pyetjet kërkimore, dizajnin e studimit, metodologjinë e tezës dhe mënyrën se si do të monitorohet procesi i kërkimit shkencor.
- Studenti dhe unë kemi diskutuar dhe rënë dakord për qëllimin e kërkimit të tij/saj dhe cilat njohuri dhe/ose aftësi nevojiten për zbatimin e dizajnit të kërkimit. Sipas nevojës, kam drejtuar studentin tim të përdorë burimet e nevojshme, mundësitë e trajnimit dhe/ose konsultim.
- Sipas nevojës, kam këshilluar studentin të ketë edhe një konsulent (të jashtëm) për temën e planifikuar hulumtuese.

## Rezultatet kthyesë

- Kam konsultime të rregullta me studentët e mi dhe ndjek në mënyrë të vazhdueshme punën e tyre kërkimore.
- Unë jam gjithmonë i qartë dhe i respektueshëm në komunikimin tim.
- Gjithmonë përpiqem të jap përgjigje kthyesë konstruktive dhe të vlerësoj aspektet pozitive.
- Kontrollova/shqyrtova nëse të dhënat e studentit që e mentoroj janë mbledhur, regjistruar dhe menaxhuar siç duhet.

## Përpunimi dhe analiza e të dhënave

- Studenti dhe unë kemi rënë dakord për metodat e përpunimit dhe analizës së të dhënave që ai/ajo do të përdorë.
- Kam biseduar me studentin tim për faktorët që mund të ndikojnë në objektivitetin në analizën e të dhënave, siç janë format e ndryshme të paragjyqimeve ose konfliktet e interesit.
- E kam udhëzuar studentin që të deklarojë të gjitha kufizimet e mundshme, paragjyqimet dhe konfliktet e interesit duhet të deklarohen qartë në punën e tij/saj.
- Me studentin kemi folur rreth kërkesave për ruajtjen e duhur të të dhënave të kërkimit shkencor dhe jemi marrë vesh se si dhe ku do të ruhen të dhënat e tezës.
- Kam biseduar me studentin tim për mundësinë e përjashtimit dhe pse dhe si ato nuk duhet të hiqen nga baza e të dhënave.
- Kam biseduar me studentin tim për rëndësinë e anonimizimit të pjesëmarrësve në kërkim (nëse është e nevojshme).

## Shkrimi akademik

- E kam drejtuar studentin drejt shembujve të shkrimit të mirë akademik në disiplinën time.
- Kam inkurajuar studentin të lexojë literaturën e duhur për shkrimin akademik.

- Kam kontrolluar rregullisht tezën dhe jam siguruar që studenti është i vetëdijshëm se si të citojë siç duhet.
- Kam folur me studentin tim për rëndësinë e përdorimit të vazhdueshëm të një stili të referencave.
- E kam këshilluar studentin tim që të përdorë siç duhet softuerin e menaxhimit të referencave.
- Kam informuar studentin tim se ai/ajo duhet të kontrollojë nëse të gjitha materialet (p.sh., fotografitë, grafikët dhe tabelat) janë treguar siç duhet, me referenca dhe janë vërtetuar përpara se të dorëzohë tezën.
- Kam informuar studentin tim se ai/ajo duhet të kontrollojë listën e referencave dhe të verifikojë nëse ajo është në përputhje me referencat në tekst (citimet brenda tekstit ose fusnotat).

## Puna bashkëpunuese

- Unë dhe studentët e mi të mentoruar kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord për kontributet e autorëve në artikullin/punimin e përbashkët.
- Nëse punimi i studentit është pjesë e një projekti më të madh kërkimor, ne kemi diskutuar, kemi rënë dakord dhe kemi formalizuar marrëdhëniet ndërmjet projektit dhe punimit të studentit për sa i përket autorësisë.
- Nëse punimi i studentit është pjesë e një projekti më të madh kërkimor, ne kemi diskutuar, kemi rënë dakord dhe kemi formalizuar marrëdhëniet ndërmjet projektit dhe punimit të studentit për sa i përket përdorimit të të dhënave.
- Nëse punimi i studentit është pjesë e një projekti më të madh kërkimor, ne kemi diskutuar, kemi rënë dakord dhe kemi formalizuar marrëdhëniet ndërmjet projektit dhe punimit të studentit për sa i përket të drejtave të pronësisë intelektuale.

## Publikimi etik

- Studenti dhe unë kemi kontrolluar kërkesat eventuale të botuesit.
- Studenti dhe unë kemi kontrolluar cilësinë e revistës dhe kemi folur për botuesit mashtrues me studentin tim. Në rastin e studentëve të doktoratës, kam shpjeguar se punimi i botuar në vende të tilla nuk mund të përdoret si pjesë e tezës së tyre.
- Studenti dhe unë kemi folur për rëndësinë e renditjes vetëm të atyre që kanë dhënë kontribut përkatës në punim si autorë, siç përcaktohet nga Komiteti Ndërkombëtar i Redaktorëve të Revistave Mjekësore (ICMJE) dhe Komiteti për Etikën e Publikimit (COPE).
- Sigurohuni që studenti të jetë i vetëdijshëm se bashkëpunëtorët që nuk kualifikohen si autorë duhet të njihen siç duhet.
- Sigurohuni që studenti të jetë i vetëdijshëm për nevojën për të deklaruar konfliktet e interesit, nëse ka, dhe për t'i deklaruar hapur ato në publikim.
- Sigurohuni që studenti të jetë i vetëdijshëm për nevojën për t'ju shprehur mirënjohje atyre që financojnë kërkimin shkencor.

## Konsideratat përfundimtare

- Studenti dhe unë i kemi kontrolluar kërkesat institucionale për dorëzimin dhe/ose mbrojtjen e tezës.
- Pas dorëzimit të tezës, sipas nevojës, kam përdorur softuer për përputhjen e tekstit për të identifikuar plagjiaturën e mundshme dhe kam vlerësuar përputhjet e treguara të tekstit.
- Kam lexuar dhe analizuar me kujdes të gjithë kapitujt e tezës së magjistraturës/doktoratës së kandidatit para mbrojtjes përfundimtare.

### Shënime:

.....

.....

.....

.....